

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, mr.sc. Muhamet Rexha dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit I. M., nga ..., të cilin e përfaqëson avokati N. H., nga ..., kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a. në Prishtinë, për anulimin e vendimit dhe pagimin e pagave, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës CA.nr.708/2015 datë 25.01.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.06.2017, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit I. M., nga ..., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës CA.nr.708/2015 datë 25.01.2017.

### **A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës CA.nr.708/2015 datë 25.01.2017, refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit I. M., nga ..., dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1736/2011 datë 24.11.2014, me të cilin refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit I. M., nga ..., kundër të paditurës KEK sh.a. në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të anulohen si jo ligjore vendimi i Drejtorit Ekzekutiv nr..., datës ..., dhe vendimi i Drejtorit menaxhues nr..., datë ..., i të paditurës, si dhe kërkesa paditësit për detyrimin e të paditurës t'ia paguajë pagat e papaguara për periudhën prej datës 16.06.2011 deri më datën 31.10.2014, në shumë neto 24.747,35 €, kamatën e arritur për pagesë në shumë prej 306,45 €, kontributin për trust , në shumë prej 1.707,47 €, kurse për të ardhmen nga data 01.11.2014, t'ia paguajë pagën mujore 813,00 €, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore. Është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë revizion me kohë ka paraqitur paditësi përmes të autorizuarit të tij, avokatit N. H., nga Prishtina, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës konstestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale , me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen dhe të miratohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e bazuar.

Përgjigje në revizion ka paraqitur e paditura me propozim që revizioni i paditësit të refuzohet në tërësi si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të dispozitës së nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se sipas kontratës së punës nr.4467/0 të datës 01.03.2011, paditësi tek e paditura ka qenë i caktuar në punët e inxhinierit kryesor në realizimin e projektit“ në “...”. Me fletëparaqitjen nr..., të datës ..., ndaj paditësit është zhvilluar procedura disiplinore lidhur me shkeljen e detyrave të punës, duke u bazuar në Raporti i Auditorit të Brendshëm të paditurës (nr..., datë ...) ... KEKC-..., Dizajnim, Liferim, Montimi dhe Komisionimi i kaldajës së re 50/h Avull . Ky auditim ka pasur për qëllim rishikimin e procedurave të aplikuara prej momentit të dhënies së kërkesës njësisë së prokurimit për kaldajën e re 50/h e deri në implementimin e kaldajës nr..., Sipas gjetjeve të Auditorëve paditësi ka dështuar në përgatitjen e specifikacionit teknik për kaldajën e re ndihmese, dështimi në përcjelljen e implementimit të projektit në bazë të kontratës dhe aprovimin e punës së pakryer. Veprimet e paditësit sipas Auditorëve të Brendshëm të paditurës janë kualifikuar si veprime të pakujdesshme në kryerjen e detyrave tij që i shkakton dëm pronës së palës së tretë dhe shkelje të Kodit Disiplinor të KEK-ut, andaj, kanë rekomanduar që paditësit ti shqiptohet masa disiplinore shkëputje e kontratës së punës.

Me vendimin e Drejtorit Ekzekutiv të Divizionit nr..., datë ..., veprimet e paditësit janë kualifikuar si shkelje e rënd e detyrave të punës nga neni 7paragrafi 7.1 pika (1) i Kodit Disiplinor të KEK-ut, dhe paditësit i është shqiptuar masa disiplinore shkëputje kontratës së punës. Paditësi para komisionit disiplinor ka kontestuar shkaqet e inicimit të procedurës disiplinore duke theksuar se të gjitha punët i ka kryer në mënyrë profesionale dhe në mënyrë të ndërgjegjshme duke iu referuar provave konkrete të cilat prova paditësi nuk i ka paraqitur si në procedurë disiplinore ashtu edhe në procedurën para gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave me dëgjimin e dëshmitarëve Xh. G., i cili ka marrë pjesë në realizimin e projektit, dëgjimin e anëtarëve të auditimit I. V. dhe B. H., dhe me dëgjimin e paditësit në cilësinë e palës si dhe vlerësimin e provave tjera që gjinden në shkresat e lëndës, ka gjetur se paditësi nuk ka paraqitur provë me shkrim me të cilën do të

justifikonte pretendimin se nuk ekziston përgjegjësia e tij për shkeljet për të cilën ngarkohet. Nga ana tjetër, në procedurë disiplinore janë nxjerr prova me të cilat është vërtetuar përgjegjësia e paditësit për shkelje të detyrave të punës për të cilën i është shqiptuar masa disiplinore andaj mbi këtë bazë ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e ankimimit në tërësi ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë, andaj ka refuzuar në tërësi si të pabazuar ankesën e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështje juridike të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Të papranueshme janë thëniet në revizion se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se vendimi i të paditurës për ndërprerjen e kontratës së punës së paditësit është i paligjshëm pasi që nga ana e ekspertizës së kryer nga eksperti i makinerisë A. P., konstatohet se paditësi nuk është fajtor për shkelje që i mvishen në procedurë disiplinore. Këto pretendime të revizionit nuk mund të qëndrojnë për faktin se ekspertiza në fjalë nuk paraqet referencë ligjore për marrjen e vendimit më të favorshëm për paditësin ashtu si pa bazë theksohet në revizion.

Paditësi në këtë kontest ka hequr dorë nga propozimi i tij i aprovuar nga gjykata, lidhur me administrimin e provës me ekspertizë të re të ekspertit makinerisë për vërtetimin e kontributit të tij personal në realizimin e projektit, ndërkaq pranë komisionit disiplinor si dhe në procedurën e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë nuk ka provuar pretendimet e tija lidhur me mos ekzistimin e përgjegjësisë së tij, kështu që paditësi ka dështuar të prezantojë fakte me rëndësi se ka punuar me përkushtim si profesionalist në realizimin e projektit. Ndërkaq, kjo Gjykatë nga Raporti i Auditimit të Brendshëm të paditurës nr..., datë ..., pa mëdyshje ka vërtetuar se paditësi ka bërë shkelje të detyrave të punës nga neni 7 par.7.1 të Kodit Disiplinor të KEK-ut (nr..., datë ...), veprime të pakujdesshme në kryerjen e detyrave të tija e që shkaktojnë dëme pronësore të paditurës. Andaj, me të drejtë të dy gjykatat kanë vlerësuar se vendimi i

Drejtorit Ekzekutiv të Divizionit nr..., datë ..., për shkëputjen e kontratës së punës së paditësit nuk është përfshirë me shkelje të rregullave të punës as në aspektin formal e as në aspektin material, dhe nuk përfshirë me paligjshmërinë e cekur në revizion vendimin e Drejtorit Ekzekutiv të Divizionit nr..., datë ..., vendimin e Drejtorit Ekzekutiv të Divizionit nr..., datë ..., pasi që ndaj paditësit është zhvilluar procedura disiplinore konform Kodit Disiplinor të paditurës, paditësit i është mundësuar që të deklarohet lidhur me shkeljen në fjalë dhe gjatë procedurës është vërtetuar se paditësi i ka kryer shkeljet e detyrave të punës për të cilat i janë vuar në barë me vendimin e kontestuar dhe për këtë arsye pretendimet në revizion nuk e vejnë në dyshim ligjshmërinë e aktgjyqimit të goditur ashtu si pa bazë theksohet në revizion.

Së këndejmi, Gjykata Supreme gjen se nuk mund të pranohen si të bazuara pretendimet në revizion për shkeljen thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (n) të LPK, për faktin se aktgjyqimet e kundërshtuara nuk përfshihen me të meta të cilat këto aktgjykime i bëjnë të kundërligjshme, nga se dispozitivi dhe arsyetimi i tyre është i kuptueshëm dhe mbështet në prova të pranueshme edhe për këtë gjykatë të revizionit. Për më tepër, në arsyetimin e aktgjyqimit janë dhënë arsye për të gjitha faktet relevante, të vlefshme për gjykim të drejtë lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, të cilat janë të pranueshme edhe për gjykatën e Revizionit.

Nga sa u tha më sipër me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.66/2017 datë 29.06.2017

Kryetare e kolegjit,  
Gyltene Sylejmani